

## TERMINALI I RI NË PORTIN E VLORËS

Porti i Vlorës ofron tashmë kushte dhe standarde shumë të mira e moderne për të gjithë pasagjerët të cilët zgjedhin të udhëtojnë përmes tij. Vendosja në funksion e Terminalit të ri, me një investim prej 215 milionë lekësh ka bërë të mundur një ndryshim rrënjësor të ofrimit të shërbimeve për të gjithë udhëtarët por njëkohësisht shkurton ndjeshëm edhe kohën e pritjes. Terminali i ri ka rritur gjithashtu kapacitetin e përpunimit duke arritur në rreth 2500 pasagjerë në ditë.

## SEGMENTI TIRANË-NDROQ- PLEPA

Segmenti rrugor Tiranë-Ndroq-Plepa i është nënshtruar një ndërhyrjeje rehabilituese, e cila ka eliminuar një sërë problemesh të krijuara në këtë aks. Me një ndërhyrje të ARRSH po bëhet riparimi i shtresave asfaltike, gropave dhe pjesëve të dëmtuara në këtë segment. Puna po ecën me ritme të shpejta për t'ju ofruar banorëve të zonave përgjatë këtij aksi, por edhe përdoruesve të tjerë të tij, një rrugë me standarde më të mira.

## PORTI I DURRËSIT, INVESTIM 8.6 MILIONË EURO

Nisën punimet për thellimin e basenit dhe kanalit hyrës në Portin e Durrësit, që do të mundësojë hyrjen e anijeve prej 20.000 ton. Investimi do t'i japë një shtysë të madhe ekonomisë së vendit pasi do të përpunojë anije më të mëdha mallrash, të cilat deri më sot e kanë pasur të pamundur ankorimin në këtë port. Pjesë integrale e portit do të jetë edhe terminali i kroçierave, punimet për të cilin pritet të nisin vjeshtën e këtij viti.

## REHABILITIM AKSIT BURREL-KLOS

Vijon me intensitet puna për rehabilitimin e segmentit rrugor Burrel - Klos, me gjatësi 18.6 km. Punimet kanë përfshirë njëkohësisht si shtresat asfaltike ashtu edhe në pjesën tjetër ku po vijohet me përgatitjen e trupit të rrugës për asfalt. Janë përsheptuar ritmet me qëllim përfundimin e punimeve sipas kriterëve teknike të miratuara.

## TASK FORCA E TRANSPORTIT RRUGOR

Grupet e Task-Forcës së Transportit Rrugor kanë shtuar kontrollet në disa prej akseve rrugore të vendit, ku janë regjistruar dhjetëra akt-konstatime si dhe masa e gjoba ndaj drejtuesve të mjeteve në kundravajtje. Kontrollat do të vijojnë në funksion të luftës kundër informalitetit me transportin e pasagjerëve edhe në respekt të biznesit të ndershëm.

## INFRASTRUKTURA DIXHITALE

Nën drejtimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ka nisur zbatimi i projektit për zhvillimin e infrastrukturës rajonale të Broadband-it të miratuar nga Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF). Ky është projekti i parë për infrastrukturën dixhitale në rajon në kuadër të projekteve të konektivitetit që do t'i hapë rrugë investimeve në infrastrukturën dixhitale dhe do ndihmojë në transformimin dixhital të vendit.